

Treguesit e Shëndetit Publik

Viti 2020

Tiranë, më 20 Gusht 2021: Në vitin 2020, numri i vizitave gjithsej në shërbimin parësor spitalor është 7.353.296, mesatarisht 2,6 kontakte për person në vit. Numri i vizitave shënon një rënie me 3,9 %, krahasuar me numrin e vizitave në vitin 2019. Ditët mesatare të qëndrimit të një pacienti në spital janë 5,1 ditë gjatë vitit 2020. Në institucionet publike të shërbimit spitalor janë kryer 46.369 ndërhyrje kirurgjikale, 27,2 % më pak, krahasuar me një vit më parë.

I. Kujdesi shëndetësor parësor

Në vitin 2020, kanë operuar 413 qendra shëndetësore të degëzuara në 2.037 ambulanca dhe 46 poliklinika të specializuara. Nga 7.353.296 vizita gjithsej në shërbimin parësor, 42,8 % janë kryer në qendrat shëndetësore, 20,5 % në ambulanca dhe 36,6 % në poliklinika. Përgjatë 5 viteve të fundit, vihet re pothuasje e njëjta shpërndarje në numrin e vizitave. Mbi 40 % e vizitave në qendrat shëndetësore dhe ambulanca janë kryer nga personat mbi 60 vjeç.


Tab. 1 Aktiviteti i Qendrave Shëndetësore, Ambulancave dhe Poliklinikave

Emërtimi	Vitet				
	2016	2017	2018	2019	2020
Vizita gjithsej	8.120.123	7.942.742	8.219.771	7.650.504	7.353.296
Numri i Qendrave shëndetësore	414	413	413	413	413
Numri vizitave në Qendra shëndetësore	3.141.755	3.219.003	3.411.915	3.374.429	3.149.495
Numri i Ambulancave	2.062	2.022	2.053	2.059	2.037
Numri vizitave në Ambulanca	1.627.521	1.545.416	1.541.645	1.543.269	1.510.006
Numri i Poliklinikave	46	46	46	46	46
Numri vizitave në Poliklinika	3.350.847	3.178.323	3.266.211	2.732.806	2.693.795

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Për publikim

Fig. 1 Përqindja e vizitave të kryera në qendrat e kujdesit shëndetësor



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Konsultori i gruas

Në vitin 2020, numri i vizitave në konsultorin e gruas është 212.400, duke shënuar një rritje me 3,0 %, krahasuar me vitin 2019. Nga totali i vizitave, 85,8 % janë vizita obsetrikale, nga të cilat 61,1 % janë realizuar me asistencë të mjekut specialist. Numri i vizitave të para obsetrikale është 23,636, 16,1 % më pak, krahasuar me vitin 2019.

Tab. 2 Konsultori i Gruas

Emërtimi	Vitet				
	2016	2017	2018	2019	2020
Numri i konsultoreve	2.024	2.057	2.013	1.932	1.879
Numri i mjekëve në konsultor	762	765	728	753	756
Numri i mamive në konsultor	2.827	2.965	2.614	2.682	2.682
Numri i vizitave gjithsej	269.834	272.177	243.594	206.326	212.400
Numri i vizitave gjinekologjike	42.530	45.184	46.372	38.981	30.231
Numri i vizitave obsetrikale	227.304	226.993	197.222	167.345	182.169
- me mjek	147.044	141.717	124.994	101.938	111.288
Numri i vizitave të para obsetrikale	30.734	32.787	29.517	28.178	23.636

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Konsultori i fëmijëve

Në vitin 2020, në konsultorin e fëmijëve janë regjistruar 256.146 fëmijë dhe janë kryer 708.211 vizita, mesatarisht 2,8 vizita për fëmijë në vit. Krahasuar me vitin 2019, numri i vizitave është ulur me 9,5 %. Nga totali i vizitave, 57,9 % e tyre janë realizuar me asistencë të mjekut specialist dhe pjesa tjetër janë ndjekur nga mami dhe infermierë.

Numri i fëmijëve që ushqehen vetëm me gji gjatë vitit 2020 është 18.541, ndërkohë numri i fëmijëve që ushqehen vetëm me ushqim artificial është 4.239.

Tab. 3 Konsultori i Fëmijëve

Emërtimi	Vitet				
	2016	2017	2018	2019	2020
Numri i konsultoreve të fëmijës	2.095	2.100	2.131	2.081	2.028
Numri i vizitave në konsultor	990.563	929.330	802.633	782.532	708.211
nga këto: sa nga mjeku	501.523	534.059	455.987	423.412	410.153
Numri i fëmijëve të regjistruar në konsultor	259.354	286.092	253.403	276.306	256.146
Numri i fëmijëve që ushqehen vetëm me gji	20.928	20.702	18.988	18.317	18.541
Numri i fëmijëve që ushqehen vetëm me ushqim artificial	5.670	5.693	5.342	4.585	4.239

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Mbulesa vaksinale është mesatarisht në nivelet mbi 97,0 % duke përmbushur kështu dhe kriterin bazë, ku çdo antigen vaksinal duhet të jetë mbi 95,0 % në nivel kombëtar. Përrjashtim bënë vetëm grupi Fruth-Rubeolë dhe Parotit, me mbulim 91,0 %. Ky grup vaksinash, në vitin 2020, ka rënë me 4,0 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2019.

Tab. 4 Mbulimi vaksinal, në %

Emërtimi	Vitet				
	2016	2017	2018	2019	2020
Fëmijë të vaksinuar për:					
Tuberkuloz	99,2	99,0	99,1	98,9	97,9
Difteri	98,7	99,0	99,8	98,6	98,5
Tetanoz	98,7	99,0	99,8	98,6	98,5
Pertus	98,7	99,0	99,8	98,6	98,5
Fruth-Rubeolë - Parotit	96,3	95,7	94,1	95,0	91,0
Poliomilit	98,3	98,9	98,7	98,6	98,3

Burimi: Instituti i Shëndetit Publik

II. Shërbimi spitalor dytësor

Në vitin 2020, numri i spitaleve publik dhe jopublik në vend është 58, nga të cilët 42 janë spitale publike dhe 16 spitale private. Mbulimi i shërbimit spitalor publik dhe jopublik është 2 spitale për 100 mijë banorë dhe numri i shtretërve spitalorë publik dhe jopublik është 9.196 ose 3,2 shtretër për 1.000 banorë.


Tab. 5 Tregues të aktivitetit në institucionet publike të shërbimit spitalor

Treguesit e aktivitetit në Spitale Publike	Vitet				
	2016	2017	2018	2019	2020
Numri i institucioneve spitalore	42	42	42	42	42
Numri i shtretërve në total	8.172	8.169	8.185	8.189	8.334
Të shtruar në institucione	275.165	273.046	279.018	282.962	201.449
Ditë-shtretër të realizuar	1.470.515	1.444.336	1.528.499	1.491.930	1.032.922
Shfrytëzimi i shtratit në ditë	179,9	176,8	186,7	182,2	123,9
- në %	49,3	48,4	51,2	49,9	33,9
Ditë qëndrimi mesatar të sëmurit në spital	5,3	5,3	5,5	5,3	5,1
Xhiro e shtratit	33,7	33,4	34,1	34,6	24,2
Të sëmurë të operuar gjithsej	52.248	57.475	64.929	63.669	46.369

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Në institucionet publike të shërbimit spitalor, në vitin 2020 numri i të shtruarve është 201.449 pacientë. Ditët e qëndrimit mesatar të një pacienti janë 5,1 ditë në vit me një xhiro të shtratit 24,2 herë pacientë në vit. Shfrytëzimi i një shtrati për kujdes shëndetësor gjatë vitit 2020 është 123,9 ditë, të cilat përbëjnë 33,9 % të ditëve kalendarike të këtij viti. Nga totali i pacientëve të shtruar, 23,0 % e tyre kanë kryer ndërhyrje kirurgjikale.

Fig. 2 Pacientë të shtuar dhe ditë mesatare të qëndrimit në institucionet publike të shërbimit spitalor



Metodologjia

Botimi “Treguesit e Shëndetit Publik” përmban të dhëna administrative mbi shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor dhe shërbimin spitalor dytësor, me frekuencë vjetore. Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ndërkohë të dhënat mbi shërbimin vaksinal kanë burim informacioni Institutin e Shëndetit Publik.

Përkufizime

Qendrat e kujdesit shëndetësor parësor janë të gjitha institucionet shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për pacientët në mënyrë ambulante, të cilat janë të pajisura me të paktën një personel mjekësor, mjek ose infermier (nuk përfshihet shërbimi i stomatologjisë).

Spitali është një rezidencë institucionale që ofron kujdes mjekësor, hoteleri-24 orë, diagnostikim, trajtim dhe rehabilitim të të sëmurëve që mund të kenë nevojë për ndihmë mjekësore ose kirurgjikale.

Shtretër spitalorë janë shtretër për akomodimin e pacientëve, të cilët janë pranuar formalisht në një institucion për trajtim ose kujdes, dhe që qëndrojnë minimumi një natë. Këtu përfshihen shtretër në të gjitha spitalet, përfshirë spitalet e përgjithshme, spitalet e shëndetit mendor dhe të abuzimit me substancat, spitalet e specialitetit, pavarësisht nëse krevati është i zënë apo jo.

Shfrytëzimi i shtratit në ditë është numri i ditëve mesatare të vitit gjatë të cilave një shtrat i spitalit është i zënë me pacientë.

Ditë shtretër të realizuar është shumëzimi i shfrytëzimit të shtratit në ditë me numrin e shtretërve në spital.

Shtrime spitalore është raporti i numrit të pacientëve të dalë nga spitalet në një vit me numrin e popullsisë së atij viti.

Xhiro e një shtrati është numri i të sëmurëve që janë shtruar në një shtrat gjatë vitit.